RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

KOMUNIKATË

Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës, mbajti mbledhjen e radhës sipas agjendës së përcaktuar në rend dite.

Sot, me datë 25 maj 2026, në mbledhjen e mbajtur te Bordit te Radiotelevizionit të Kosovës, u trajtuan çështje me rëndësi për funksionimin financiar dhe programor të RTK-së.

Gjatë mbledhjes, Bordi shqyrtoi gjendjen financiare të RTK-së, masat e ndërmarra nga menaxhmenti dhe ndikimin e tyre në funksionimin e institucionit. Bordi i RTK-së i dha mbështetje të plotë Ushtrueses së Detyrës së Drejtoreshës së Përgjithshme për angazhimet institucionale drejt gjetjes së zgjidhjeve për tejkalimin e situatës aktuale financiare deri në konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, Bordi shqyrtoi raportin mujor të punës për muajin prill 2026, të gjeturat nga Raporti i Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2025 dhe planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Në kuadër të rendit të ditës, Bordi shqyrtoi organizimin e edicionit të IV-të të Festivalit të Këngës në RTK për vitin 2026, si dhe miratoi propozimin për emërimin e z. Rilind Gërvalla Drejtor të Festivalit të Këngës në RTK për edicionin e IV-të.

Bordi i RTK-së mbetet i përkushtuar për ruajtjen e stabilitetit institucional dhe funksionimit të transmetuesit publik.